Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 138/17
Datë/Datum. 24.05.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN.**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.138/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete"**, me nr. prokurimi: **2017/001/236.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "PBC"sh.p.k, Prishtinë.**		
Datë	**24.05.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete"**, me nr. prokurimi: **2017/001/236,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **"PBC"sh.p.k**, me seli në – Prishtinë, me nr.prot.138/17, i datës **12.05.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		16.05.2017		17.05.2017		24.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 12.05.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 138/17 e parashtruar nga operatori ekonomik në "PBC" sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete", me nr. prokurimi: 2017/001/236, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU HIDROMORAVA sh.a - Gjilan.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, me vetëdije, kërcënon me shkelje:

- Paragrafin e 2'të të nenit 7 të Ligjit për Prokurim Publik
- Paragrafin e 2'të nenit 28 të Ligjit për Prokurim Publik
- 18.4 te Udhëzuesit Rregullave për Prokurim Publik
- Nenin 108/A paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik
- Nenin 109, paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Konsiderojmë se, Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 2 të nenin 7 dhe paragrafin e 2'të të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sepse:

   a. Në procedurën e prokurimit në fjalë, autoriteti kontraktues ka përpiluar specifikacion teknik që nuk sigurojnë qasje të barabartë për operatoret ekonomik që janë të interesuar për ketë procedurë të prokurimit. Dhe, ka ekzekutuar aspekte qe favorizojnë një prodhues e diskriminojnë te gjithë e tjerët.

   Në vazhdim po i paraqesim disa nga diskriminimet dhe favorizimet ndaj OE të caktuara nga Autoriteti Kontraktues.

   Prova A: Në faqen 13 të dosjes së tenderit tek paragrafi *"System functionalities"*

kërkohet:

The system must allow access to information on the fleet via native applications dedicated to iOS and Android. The Mobile Application must be downloaded from Google Play and App Store. For this requirement no alternatives desktop applications to be responsive on mobile devices will be accepted.

Kërkesa juaj e emëruar nga ne si Prova A, përben shkelje të rende të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 pasi që ketë kërkesë e plotëson vetëm OE Smartivo.

Për informaten tuaj, në linkun e mëposhtem mund të shihet qartë favorizimi ndaj ketij OE: http://smartivo.com/en/faq/#toggle-id-19

Prova B: Në faqen 13 të dosjes së tenderit tek pjesa *"Software functionalities"* kërkohet:

The software application must allow the possibility of receiving the data transmitted by equipment installed in the vehicle via a web browser; the data is automatically transmitted by the vehicles through GSM/GPRS. No desktop software will be allowed to be installed on the computers of CA.

Kërkesa juaj tek *"System functionalities"* emëruar nga ne si Prova A, bie në kundërshtim me kërkesën tuaj tek *"Software functionalities"* e emëruar nga ne si Prova B dhe si e tillë është në kundërshtim me paragrafin 18.4 të Udhëzuesit Rregullave për Prokurim Publik SEPSE:

AK fillimisht tek paragrafi *System functionalities*, kërkon që aplikacioni për monitorimin e lëvizjeve të automjeteve të shkarkohet vetëm nëpërmjet dyqaneve elektronike Google Play dhe App Store ku e specifikon që ndalon alternativat tjera, ndërsa tek paragrafi *Software functionalities* AK kërkon që aplikacioni të jetv web browser. Pra, shihet shumë qartë se ju si AK keni përpiluar terma te references të paqarta dhe se nuk është në përputhje me Udhëzuesit Rregullave për Prokurim Publik.

2. Konsiderojmë se, Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 2 të Nenit 108/A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me

ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, sepse:

- Autoriteti Kontraktues nuk ka pezulluar zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar duke vepruar ne kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 2 të LPPK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet matieriale per kompaninë tone sillen rreth 1,000 euro, si fitim i mundshëm, ndërsa per AK'ne janë multi-dispilinare. Te dyja këto mund te evitohen me nje lehtësi te jashtëzakonshme nga Autoriteti Kontraktues dhe te mundësohet realizim i suksesshëm i kontratës.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

a. Kopja e publikimit të "Njoftimit për Kontratë",
b. Kopja e 'Kërkesës për Rishqyrtim', sipas nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse
c. Prova "A" e cila dëshmon se vetëm OE Smartivo plotëson kërkesën teknike të parashtruar nga AK.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :	14.02.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):	Procedur e hapur/vlerë e vogel
Lloji i kontratës së publikuar(N.16):	Furnizim/koutim çmimi
Afati i fundit për pranim të tenderëve:	12.05.2017
Data e Hapjes së ofertave:	12.05.2017, ora 10;30h
Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit në KRPP:	*NUK ka*
Kriter për dhënien e kontratës:	*Tenderi përgjegjshëm, çmimi më i ulët*

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	NAS SYSTEM	GJILAN	-	8,452.00€	JO
2	TECH SH.P.K	PRISHTINË	-	2,570.26€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar dy (2) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

OFERTA E PËRGJEGJSHME ME ÇMIM MË TË ULËT.

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1) Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 \ L-42. LPP i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net.
2) Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimit ne pron

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1)Evidenca:Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit- Aneksi 2-Origjinal.
2) Te sjellet dokumenti origjinal mbi pagesen e tatimit ne pronwe nga Komuna

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
Kërkesa 2. Regjistrimi i Numrit Fiskal
Kerkesa 3.Regjistrimi ne tvsh

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
Evidenca 2: Certifikata e numrit fiskal- kopje
Evidenca 3: certifikata e nr, tvsh -kopje
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kerksea 1 Operatori ekonomik duhet te ket qarkullim Bankar te pakten 18,000.00 euro tri vitet e fundit (2014-2015-2016)
Deshmia e kerkuar dokumentare
Evidenca: Te sjellet deshmi nga banka (dokument bankar mbi qarkullimin vjetore financiar)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kerkesa 1:OE të ketë së paku një inxhinier të shkencave kompjuterike, elektronikës apo telekomunikacionit, të dëshmohet me kopje të diplomës apo certifikatës universitare.
Kerkesa 2: OE duhet të jetë i autorizuar për shitje dhe sevisimin e pajisjeve që oferton (ne ket raste paisje GPS-per Automjete)

Kerkesa:3.Operatori ekonomik duhet te ket ISO qertifikatat per veprimtari te ngjashme (sisiteme te IT-s)
Kerkesa 4.OE të ofroi dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku 2 projekte te lemës se kërkuar në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca:1 Te sjellet dokument , të dëshmohet me kopje të diplomës apo certifikatës universitare inxhinieri qe punon në Kompanin tuaj ofertuese (kontrate punes).

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur/lloji kontratës furnizim/ koutim i çmimit, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për kontrat dhe kriteret e FDT-së, për këtë aktivitet të prokurimit të datës 14.02.2017, operatoret ekonomik ankues PBC sh.p.k, ka parashtruar ankes në OSHP, me datë 12.05.2017, me pretendimet ankimore se kriteret e FDT janë diskriminuese në kundërshtim me nenin 7 dhe 28 të LPP-së

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor nr.1

Eksperti shqyrtues, njofton Panelin shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kritereve të dosjes së tenderit në lidhje me specifikimin teknik, se të njëjtat kritere janë shqyrtuar paraprakisht nga ana panelit shqyrtues në bazë të vendimit të OSHP-së nr.55/17, të datës 27.04.2017, duke u bazuar në ankesën e OE PBC sh.p.k, dhe njëherit dua të njoftoj Panelin se Autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me vendimin e lartë cekur nr.55/17, duke eliminuar kriterin diskriminues të dosjes së tenderit në lidhje me specifikimin teknik sa i përket kriterit: "hostimi i platëformes së GPS të bëhet vetëm në shtetet e BE", ky kriter është eliminuar nga ana e panelit shqyrtues me vendimin e lartë cekur, ndërsa kriteret tjera në lidhje me specifikin teknik ka qenë konform nenin 7 dhe 28 të LPP-së.

Pretendimi ankimor nr.2

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 108/A, paragrafi 2 i LPP-së,
Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lendes vlerëson se Autoriteti kontraktues NUK ka vepruar në harmoni më këtë dispozit të ligjit, konkretisht ne harmoni me paragrafin 2 të nenin 108/a, për faktin se i njëjti nuk ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit edhe paragrafi i lartë cekur e obligon AK-në që në raste të kërkesës për rishqyrtim të vendimit të pezulloj aktivitetin e prokurimit.

Eksperti shqyrtues REKOMANDON Autoritetin kontraktues në të ardhmen, në raste kur kemi kërkës për rishqyrtim të vendimit, të respektoj nenin 108/A, paragrafi 2, të pezulloj aktivitetin e prokurimit deri në zgjidhjen finale në lidhje me kërkesën për rishqyrtim (ankesën).

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si pjesërisht të BAZUAR ankesën (vetëm në pretendimin ankimor lidhur me nenin 108/A.2 të LPP-së), OE "PBC" sh.p.k, me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të lejohet Autoriteti kontraktues KRU Hidromorava sh.a, të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit: "Vendosja dhe mirëmbajtja e GPS-ve në Automjete", me nr. prokurimi: 2017/001/236, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KRU HIDROMORAVA SH.A – GJILAN.